



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
MINISTRI

Nr. 17501 / Prot. 1

Tiranë, më 30 / 1 / 2019

URDHËR

Nr. 28, Datë 30 / 1 / 2019

“PËR SHPALLJEN E NDRYSHIMEVE TË STANDARDIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT NR. 2 “PARAQITJA E PASQYRAVE FINANCIARE” DHE STANDARDIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT NR. 9 “KOMBINIMET E BIZNESEVE DHE KONSOLIDIMI”, TË PËRMIRËSUAR”

Në mbështetje të nenit 4, pikës 3, të Ligjit Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar, të Vendimit nr. 2, datë 26.09.2018 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit “Për miratimin e ndryshimeve të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 2 dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 9, të përmirësuar”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 2 “Paraqitja e pasqyrave financiare” (SKK 2) dhe të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 9 “Kombinimet e bizneseve dhe konsolidimi” (SKK 9).
2. Ndryshimet e SKK 2 dhe SKK 9, të përmirësuar, të publikuara në vitin 2018, do të zbatohen në pasqyrat financiare që mbulojnë periudhat kontabël që fillojnë më ose pas datës 01.01.2019. Ndryshimet zbatohen në prospektivë.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

